

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Have Haliti, kryetare, Fillim Skoro, gjyqtar referues e Xhevdet Abazi, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Sadik Kryeziu, si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarve D.B.1. për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par 5 lidhur me par1 nën par, 1.2 të KPRK-së, për veprën penale mbajtja ne pronësi kontrolle, ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 2 të KPRK-së, si dhe veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 të KPRK-së, D.B.2. për shkak të veprës penale pjesëmarrje në rrahje nga neni 190 par.1 të KPRK-së, dhe XH.B. për shkak të veprës penale mbajtja ne pronësi kontrolle dhe posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së ,duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit D.B.1. av. R.S. e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore DKR në Ferizaj PKR nr. 178/18 të dt.26.10.2018 ne seancën publike te kolegjit të mbajtur me dt .31.01.2019 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e ankesës të mbrojtësit të akuzuarit D.B.1., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj, PKR nr. 178/18 të dt.26.10.2018 sa i përket vendimit mbi dënimin ashtu që Gjykata e Apelit, të akuzuarit për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par 5 lidhur me par 1 nën par, 1.2 të KPRK-së, më afër të përshkruar si në dispozitivin I të aktgjykimit, ia shqipton dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 3 (tre) muaj, ndërsa dënimet e shqiptuara për veprat penale mbajtja ne pronësi kontrolle, ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 2 të KPRK-së, dënimin e shqiptuar me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro, dhe për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 të KPRK-së, dënimin me gjobë te shqiptuar ne shumë prej 400 (katërqind) euro i merr si të vërtetuara, edhe Gjykata e Apelit në bazë te nenit 80 par. 2 nën par 2.2 dhe 2.4 ia shqipton dënimin unik në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e tre(tre) muaj dhe dënimin me gjobë ne shumë prej 800(tetëqind) euro, dhe i akuzuari dënimin e shqiptuar me gjobë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse të njëjtin nuk e paguajnë në afatin e caktuar, dënimi i shqiptuar me gjobë do të zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20 (njëzet)Euro, do të llogaritet një ditë burgim.

II. Në pjesët tjera aktgjykimi mbetet i pa prekur.

Arsyetim

Gjykata Themelore-DKR, në Ferizaj, me aktgjykimin e saj, PKR.nr.178/18 të dt.26.10.2018, i ka shpallur fajtor të akuzuarit D.B.1. për shkak të veprave penale, lëndim i rënde trupor nga neni 189 par 5, lidhur me par.1 nën par 1.2 të KPRK-së, veprën penale mbajtja ne pronësi kontrolle, ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 2 të KPRK-së, si dhe veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 të KPRK-së, D.B.2. për shkak të veprës penale pjesëmarrje në rrahje nga neni 190 par.1 të KPRK-së, dhe XH.B. për shkak të veprës penale mbajtja ne pronësi kontrolle dhe posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së, gjykata e shkallës së parë të akuzuarit D.B.1. për veprën penale, lëndim i rënde trupor nga neni 189 par 5, lidhur me par.1 nën par 1.2 të KPRK-së, ia ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 4 (katër) muaj, për veprën penale mbajtja ne pronësi kontrolle, ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 2 të KPRK-së, ia ka shqiptuar dënimin me gjobë ne shumë prej 400 (katërqind) euro, dhe për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 të KPRK-së ia ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve dhe dënimin me gjobë ne shumë prej 400 (katërqind) euro.

Konform nenit 80 par. 1 dhe 2 dhe nën par 2.5 të KPRK-së të akuzuarit D.B.1. gjykata ia ka shqiptuar dënimin unik ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muajve dhe dënimin me gjobë ne shumë prej 800 (tetëqind) euro.

Në dënimin e shqiptuar me burg të Akuzuarit D.B.1. do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim prej dt. 28.08.2018 deri me dt. 26.10.2018 kurse ne bazë te nenit 367 par. 1 nën par 1.2 të KPRK-së gjykata me aktvendim të veçantë të akuzuarit ia ka ndërpre masën e paraburgimit.

Të akuzuarit D.B.2. ia ka shqiptuar dënimin me gjobë ne shumë prej 500 (pesëqind) euro të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaje në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Të akuzuarin XH.B. për shkak të veprës penale mbajtja ne pronësi kontrolle dhe posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së ia ka shqiptuar dënimin me gjobë ne shumë prej 300 (treqind) euro dhe për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së, ia ka shqiptuar dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale dhe dënim me gjobë ne lartësi prej 300 (treqind) euro.

Konform nenit 80 par .1 dhe 2 nën par 2.5 të KPRK-së të akuzuarit XH.B. ia ka shqiptuar dënimin unik me burgim ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se i pandehuri në periudhën kohore prej një viti nuk kryen vepër tjetër penale dhe dënim me gjobë ne shumë prej 600(gjashtëqind) euro.

Obligohen të pandehurit D.B.1., D.B.2., dhe XH.B. që dënimet e shqiptuara me gjobë t paguajnë ne afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë, në te kundërtën ne rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera të parapara me nenin 46

par.3 të KPRK-së, dënimi i shqiptuar me gjobë, të akuzuarve do të iu shndërrohet ë dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 euro do të iu llogaritet nga një dit burgim.

Të akuzuarit D.B.1. i është konfiskuar në mënyrë te përhershme arma gjysmë automatike me nr. Serik C-48478 dhe nga i pandehuri XH.B. revolva e tipit Zastava, e kalibrit 7.62 mm, me nr. Serik 16501.

Obligohen të akuzuarit D.B.1., D.B.2. dhe XH.B. që ne emër të paushallit gjyqësorë secili veç e veç që të paguajnë shumën prej 30 euro, si dhe të paguajnë shumën secili nga 50 euro në Fondin e kompensimit të viktimave të dhunës, kurse i akuzuari D.B.1. në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë edhe shumën prej 20 euro, për (ekspertizë mjekësorë), të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi me kohë ka ushtruar ankesë:

-Mbrojtësi i të akuzuarit D.B.1. av. R.S. për shkak të vendimit mbi sanksionin penal me propozimin që Gjykata e Apelit për veprën penale si ne pikën I të dispozitivit të ia ul dënimin e shqiptuar me burg, dhe për pikën II dhe III të dispozitivit të ia ulë dënimin e shqiptuar me gjobë.

Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj, PPA/I.nr.571/2018, të dt.26.12.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit D.B.1. ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar dhe aktgjykimi i gjykatës se shkallës se parë te vërtetohet.

Gjykata e Apelit, caktoi seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën të nenit 390 të KPP, ku morën pjesë i akuzuari D.B.1. mbrojtësi i të akuzuarit av. R.S. ndërsa ne seancë nuk kanë qenë te pranishëm të akuzuarit D.B.2., XH.B. dhe Prokuroria e Apelit edhe pse kanë qenë te njoftuar ne mënyre te rregullt.

Pretendimet ankimore të paraqitura dhe gjetjet e gjykatës.

-Mbrojtësi i të akuzuarit D.B.1. av. R.S. pretendon se me matjen e lartësisë se dënimit gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikuar në lartësinë e dënimit në bazë te nenit 73 të KPRK-së, dhe me dënimin e shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj dhe me gjobë ne shumë prej 800 (tetëqind) euro është mjaft i lartë sepse i akuzuari D.1. është i pa punë dhe nuk ka kurrfarë të ardhura tjera dhe jeton me një familje tetë anëtarësh, gjykata e shkallës se parë si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajit nga ana e të akuzuarit, se është penduar thellë, është i pa punë dhe me premtimin se ne te ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla penale, se është pajtuar me të dëmtuarin XH.B., dhe si pasojë e mos vlerësimit të drejtë te këtyre rrethanave gjykata ka shqiptuar dënimin unik në kohëzgjatje prej ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muajve dhe dënimin me gjobë ne shumë prej 800 (tetëqind) euro i cili dënim është tejet i lartë dhe mund te ndikoj negativisht te i akuzuari.

Gjykata e Apelit në pajtim me dispozitën e nenit 394 par.1 te KP të Kosovës, vlerësoi ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, si dhe të sqarimin me shkrim të Prokurorisë së Apelit, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, dhe gjeti se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit D.B.1. është e bazuar.

Gjykata e Apelit, në pajtim me nenin 394 par.1 të KPP, duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesat e mbrojtësit të akuzuarit, e duke vepruar edhe sipas detyrës zyrtare, në kuptim të ekzistimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 dhe shkeljes së ligjit penal, nga neni 385 par.1 të KPP, Gjykata e Apelit, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është përfshirë në shkeljet e cekura më lartë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Gjykata e Apelit, duke e vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, përkitazi me vendimin mbi dënimin, e sipas pretendimit ankimor të mbrojtësit të akuzuarit av R.S. gjen se ajo është e bazuar, dhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, nuk ka vlerësuar rrethanat lehtësuese lidhur me vendimin mbi dënimin e shqiptuar me burgim për te akuzuarin D.B.1., se i akuzuari ka pranuar fajësinë, që nënkupton pendimin e thellë të tij, për veprat penale të kryera dhe ka shprehur keqardhje ndaj të dëmtuarit dhe janë pajtuar, duke marrë parasysh edhe gjendjen ekonomike dhe familjare të tij, është i gjendjes se varfër ekonomike, se gjer me tani nuk ka qenë i dënuar gjë që tregon se jeta e mëparshme e tij ka qenë në harmoni të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, e duke marrë parasysh edhe qëndrimin korrekt dhe sjelljet e tija pas kryerjes së veprës penale, gjykata ndryshoi aktgjykimin të akuzuarit D.B.1. dhe për veprat penale për të cilat është shpallur fajtorë ia shqiptoi dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e tre (tre) muaj dhe dënimin me gjobë në shumë prej 800(tetëqind) euro dhe dënimet e shqiptuara komulative me burgim dhe me gjobë, janë në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, me bindje se dënimi i shqiptuar ndaj tij, do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 41 të KPRK-së, si preventives individuale që të parandalojë të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen ,dhe preventivës e përgjithshme që ti parandalojë edhe personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Meqë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ndryshuar u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në konformë të nenit 403 par.1 të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.602/2018, me dt.31.01.2019

Procesmbajtës,

Sadik Kryeziu

Anëtarët e Kolegjit

Fillim Skoro

Xhevdet Abazi

Kryetare e Kolegjit

Hava Haliti